



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D' Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

[Tel/Fax: +355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/E17-13 Prot.
Nr. Dok. 202401236/13 (202501334)

Tiranë 13/02/2025

Lënda: *Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për vlerësimin e mundësive për ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për familjen M.*

BASHKISË VORË

Të nderuar,

Avokati i Popullit si një institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Në përmbushje të misionit kushtetues, si garant i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, si dhe nxitës i standardeve më të larta të këtyre të drejtave, institucioni i Avokatit të Popullit i kushton një vëmendje të posaçme grupeve në nevojë dhe ndjek me prioritet mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të tyre.

Në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore¹, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë në administrim ankesën e qytetares E. M., banuese në Vorë.

Sipas shpjegimeve të parashtruara në ankesë, familja e znj. M. jeton në kushte shumë të vështira ekonomike. Qytetarja është e papunë, bashkëshorti i saj është i sëmurë dhe ka dy fëmijë, njërin të diagnostikuar me epilepsi. Kjo familje jeton në kushte shumë të vështira dhe të papërshtshme për banesë, në një kontenier. Aktualisht familja M., e përbërë nga katër persona, po jeton vetëm me të ardhurat nga pagesa e KMCAP-it të djalit sepse i është ndërprerë ndihma ekonomike. E vetmja arsye që i është dhënë nga strukturat përgjegjëse për ndihmën ekonomike është se nuk ka marrë pikët në sistem.

Në vijim të procedurave për hetimin administrativ², me qëllim vlerësimin e pretendimeve të ankueses dhe trajtimin e mundshëm të kësaj problematike, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar informacion dhe shpjegime nga Bashkia Vorë dhe DRSHSSH Tiranë.

Në përgjigje të shkresës nr. K1/E17-2 Prot, datë 20.09.2024 “Kërkesë për shpjegime”, Bashkia Vorë na informon:

Mbështetur në VKM nr. 722, datë 11.11.2019, dhe vendimin e Shërbimit Social Shtetëror, Z. A. M. është trajtuar si person me aftësi të kufizuara në nivelin e tretë (niveli i rëndë), me një përfitim mujor prej 14,565 lekësh dhe një pagesë për përkujdesje prej 11,652 lekësh, ku kujdestare është znj. E. M. Familja e Z. A. M. përbëhet nga katër anëtarë, janë të papunë, jetojnë në një kontenier të papërshtatshëm për jetesë dhe kanë të ardhura mujore totale prej 26,217 lekësh nga përfitimet e KEMP-it.

Banesa e tyre është dëmtuar nga tërmeti i 26.11.2019 dhe, në kuadër të programit të rindërtimit, familja ka përfituar 2,617,558 lekë, nga të cilat është lëvruar kësti i parë (60%), ndërsa kësti i dytë nuk është shpërndarë për mungesë fondesh. Për ndihmë ekonomike, familja nuk është shpallur përfituese për muajin shtator 2024 për shkak të mungesës së pikëve të nevojshme. Nga Bashkia Vorë, familja është ndihmuar me pako ushqimore dhe është referuar për punësim pranë AKPA.

¹ Nr.8454, datë 4.2.1999, plotësuar me ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me ligjin nr.9398, datë 12.05.2005, shtuar dhe ndryshuar me ligjin nr.155/2014, datë 27.11.2014 “Për Avokatin e Popullit”.

² Neni 13, paragrafi i parë: “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”.

Në përgjigje të shkresave nr. K1/E17-3 Prot, datë 20.09.2024 “Kërkesë për shpjegime” dhe nr. K1/E17-8 Prot., datë 23.10.2024 të Avokatit të Popullit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Tiranë na informon se:

Familja M. e përbërë nga katër anëtarë jeton në kontenier i cili është i papërshtatshëm për jetesë. Të ardhurat e kësaj familjeje vijnë nga pagesa e kempit të djalit dhe kujdestarisë së znj. E., në total 26,217 lekë në muaj. Nga verifikimi në sistemin elektronik të pikëzimit rezulton se familja nuk ka dalë përfituese. Familjet, të cilat nuk dalin përfituese dhe rezultojnë të jenë në nevojë, trajtohen nga fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike. Si rrjedhojë kontaktua me zyrën e shërbimeve shoqërore të Bashkisë Vorë dhe familja do të trajtohet nga fondi 6% që nga muaji shtator e në vazhdim. Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Politikave të Bashkisë Vorë, banesa e kësaj familjeje është dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019. Z. A. M. ka përfituar nga programi i rindërtimit në kategorinë DS5 në vlerën 2.617558 lekë, nga të cilat ka marrë vetëm këstin e parë 60% me vlerë 1.570535 lekë. Kësti i dytë nuk është lëvruar pasi nuk ka fond. Në momentin kur do të ketë fonde do të behet lëvrimi 100% i tij.

Nga komunikimi telefonik që kemi patur me ankuesen pas administrimit të përgjigjeve nga institucionet vendore, na është bërë me dije bashkëshorti i saj është në gjendje jo të mirë shëndetësore (vuan nga veshkat dhe stomaku) dhe e ka shumë të vështirë për të gjetur një punë të përshatshme. Ndonëse janë interesuar mundësitë për t’u punësuar në vendin ku jetojnë janë të pakta. Ndërkohë, problematika e mospëfitimit të ndihmës ekonomike vijon të mbetet e pazgjidhur.

Më tej, institucioni i Avokatit të Popullit, në vijimësi, me anë të disa shkresave të përsëritura zyrtare³, i ka kërkuar Bashkisë Vorë, informacion shtesë mbi ecurinë e trajtimit të mundshëm të problematikës që paraqitet në ankesën e qytetares si dhe të masave që janë marrë, apo janë parashikuar të ndërmerren, për zgjidhjen e kësaj situate shqetësuese, por Bashkia Vorë nuk ka kthyer më përgjigje.

Aktualisht, pas më shumë se katër muajsh, procesi i shqyrtimit të kësaj çështjeje nga Avokati i Popullit është bërë i pamundur për shkak të mungesës së

³ Shkresa nr K1/E17-7 prot., datë 23.10.2024, Bashkisë Vorë, me lëndë: “Kërkesë për informacion shtesë”.

Shkresa nr K1/E17-10 prot., datë 19.11.2024, Bashkisë Vorë, me lëndë: “Kërkesë e përsëritur për informacion shtesë”.

Shkresa nr K1/E17-11 prot., datë 11.12.2024, Bashkisë Vorë, me lëndë: “Kërkesë e përsëritur për informacion shtesë”.

Shkresa nr K1/E17-12 prot., datë 20.12.2024, Bashkisë Vorë, me lëndë: “Kërkesë e përsëritur për informacion shtesë”.

bashkëpunimit dhe refuzimit për të dhënë shpjegimet e kërkuara nga personat përgjegjës të Bashkisë Vorë. Ky mosveprim përbën një shkelje të qartë të dispozitave ligjore dhe kushtetuese, të cilat garantojnë të drejtën e Avokatit të Popullit si një institucion kushtetues për të kërkuar informacione dhe shpjegime nga çdo organ i administratës publike, si dhe detyrimin e këtyre organeve për t'iu përgjigjur kërkesave të tij brenda kuadrit ligjor dhe kushtetues.

Në rrethanat e parashtruara më sipër, mosbashkëpunimi për dërgimin e informacionit të kërkuar nga institucioni ynë përbën shkelje të parimeve kushtetuese dhe ligjore. Pra, parimi i bashkëpunimit në këtë rast është kushtetues dhe detyrues për të gjitha organet e administratës shtetërore, duke i detyruar ato t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, pa përjashtime.

Rëndësia e këtij parimi konstatohet edhe në instrumentet ligjore që kushtetuta i ka vënë në dispozicion Avokatit të Popullit, në rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut apo mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit nga organet e administratës publike apo funksionarët publikë⁴.

Parimi i bashkëpunimit mes organeve të administratës publike është sanksionuar si në Kodin e Procedurës Administrative, ashtu dhe në ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore”⁵. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucionet e pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin”.

Duhet theksuar se Avokati i Popullit është institucion kushtetues, i cili ka rol “kontrollues” mbi veprimtarinë e organeve të administratës publike në lidhje me zbatimin e respektimin e të drejtave kushtetuese, duke ndihmuar individët që t'u

⁴ Ligji nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, parashikon të drejtën e institucionit tonë për të kërkuar nga autoriteti kompetent, marrjen e masave administrative në rast të refuzimit për bashkëpunim nga organet e administratës publike apo nëpunësit e tyre, sanksionuar në nenin 22/1 të këtij ligji, në të cilin është parashikuar se: “Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”. Neni 63 pika 1, 2 dhe 3 e tij parashikojnë instrumente të tilla ligjore, në dispozicion të Avokatit të Popullit, si raportet vjetore dhe ato të veçanta, rekomandimet kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut apo propozimi i masave ndaj nëpunësve përgjegjës.

⁵ Neni 3, përcakton se: “Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore.

krijohen shanse të barabarta, të mund të trajtohen si të barabartë në çdo marrëdhënie me administratën publike. Në këtë kuptim, krahas detyrimit të përgjithshëm për informim dhe transparencë që kanë organet publike përkundrejt palëve të treta, theksojmë se detyrimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit gjatë hetimit administrativ, përveçse një detyrim i karakterit administrativ, është gjithashtu një detyrim Kushtetues, për nga vetë specifika që ka ky institucion publik. Bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Sa më sipër, Avokati i Popullit ndonëse vlerëson përpjekjet e Bashkisë Vorë për të ndihmuar këtë familje në nevojë, thekson se mosdhënia apo mosdërgimi i informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre.

Nga ana tjetër, në kuadër të trajtimit të të drejtës për mbrojtje sociale dhe jetë dinjitoze, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në objektivat sociale⁶, ka njohur si detyra të shtetit për t'i siguruar çdo qytetari shqiptar, jetë dinjitoze dhe shërbime publike cilësore sa i përket sigurimit të ushqimit të nevojshëm, strehimit, shëndetit dhe arsimimit, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike apo fetare.

Në këtë kontekst, politikat e mbrojtjes sociale në Shqipëri mbeten një shtyllë thelbësore për mbrojtjen e të drejtave dhe dinjitetit të qytetarëve, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të qëndrueshme, ku askush nuk mbetet pas.

⁶ Neni 52 i Kushtetutës garanton të drejtën për sigurime shoqërore për çdo individ, si në rast pleqërie dhe paaftësie për punë, ashtu edhe në rast papunësie për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij, duke ofruar mbështetje brenda kornizës ligjore dhe sistemeve të përcaktuara.

Neni 59 i Kushtetutës – Objektivat sociale të shtetit: **Pika c:** “Garantimi i një niveli jetese të arsyeshëm për të gjithë qytetarët.”; **Pika d:** “Përkujdesja dhe ndihma për të moshuarit, jetimët dhe invalidët.”; **Pika e:** “Zhvillimi i strehimit dhe përmirësimi i kushteve të banimit.”; **Pika f:** “Shëndetësia publike dhe mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse.”; **Pika g:** “Arsimi, kultura dhe shkenca si garanci për zhvillimin e plotë të personalitetit të individit.”

Këto politika të ndërtuara mbi parimet dhe objektivat që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton si detyra të shtetit për të garantuar një jetë dinjitoze dhe shërbime publike cilësore për çdo qytetar, me fokus të veçantë tek grupet më të varfra dhe më të cënueshme, janë të harmonizuara me standardet dhe angazhimet ndërkombëtare, dhe mbështeten në dokumente të rëndësishme si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut⁷, Axhenda 2030 e Kombeve të Bashkuara⁸ dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore⁹.

Për zbatimin e këtyre parimeve, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030 dhe Plan i Veprimit¹⁰ përbëjnë bazën kryesore politike dhe operationale. Këto dokumente adresojnë varfërinë dhe krijimin e një sistemi të qëndrueshëm mbrojtës përmes masave të integruara dhe të qëndrueshme. Objektivi kryesor i strategjisë është zbutja e varfërisë dhe përmirësimi i mirëqenies përmes transformimit të skemës së ndihmës ekonomike nga një model mbështetjeje pasive në një instrument aktiv që nxit përfshirjen sociale dhe punësimin. Prioritetet përfshijnë rritjen e efikasitetit, transparencës dhe gjithëpërfshirjes, duke garantuar që mbështetja të arrijë tek ata që kanë më shumë nevojë. Skemat e ndihmës sociale me karakter jokontributiv, si programi i Ndihmës Ekonomike, kanë një rol vendimtar në arritjen e mbulimit universal. Këto programe adresojnë drejtpërdrejt nevojat e grupeve të varfra dhe të cënueshme duke siguruar që asnjë grup i marginalizuar të mos mbetet pa mbështetje. Kjo qasje e integruar dhe gjithëpërfshirëse siguron një sistem mbrojtjeje që nuk ndalon vetëm në lehtësimin e vështirësive ekonomike, por edhe në fuqizimin e individëve dhe familjeve përmes krijimit të mundësive për integrim dhe përfshirje aktive në jetën sociale dhe ekonomike. Për të realizuar këtë qasje, ligjvënësi ka vendosur mekanizmat ligjorë dhe mjetet proceduriale në dispozicion të institucioneve, bashkive/organeve të pushtetit vendor, për të mundësuar që ato të vijnë në ndihmë të shtresave në nevojë.

⁷ Neni 1: të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe në të drejta, neni 22: si anëtar i shoqërisë, gjithkush ka të drejtën e sigurimit shoqëror dhe realizimit të të drejtave ekonomike, sociale, kulturore të domosdoshme për dinjitetin e vet dhe për zhvillimin e lirë të personalitetit, me ndihmën e shtetit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar dhe në përputhje me organizimin dhe mundësitë e çdo shteti.

⁸ Progresi drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke ju kushtuar vëmendje të veçantë familjeve të varfëra dhe individëve në nevojë, ku një prej elementëve më të rëndësishëm të Qëllimit 1 për Zhvillimin e Qëndrueshëm, është arritja e mbrojtjes sociale të qëndrueshme për këdo, me fokus të varfërit dhe grupet e cënueshme.

⁹ Neni 9, njeh të drejtën e secilit për të pasur mbrojtje sociale.

¹⁰ VKM Nr. 152, datë 13.3.2024 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare Të Mbrojtjes Sociale 2024–2030 dhe të Planit Të Veprimit Në Zbatim Të Saj”, <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2024/03/13/152>

Legislacioni i shërbimeve sociale në thelb synon plotësimin e nevojave të shtetasve dhe familjeve të varfra. Sidomos kur kemi të bëjmë me familje/individë në nevojë për mbështetje, bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës është i rëndësishëm, me qëllim garantimin e mbrojtjes sociale, për identifikimin e vlerësimit e çdo rasti.

Ligji Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale” synon të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror duke krijuar mundësi integrimi nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh dhe shërbimesh për përmirësimin e jetesës (neni 1, pika b), duke patur qëllim të përcaktojë ndihmën ekonomike dhe përfitimet për shkak të aftësisë së kufizuar për individët dhe familjet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike, zhvillimin e aftësive e të mundësive personale, ruajtjen e integritetit dhe përfshirjen shoqërore për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore, të zbusë varfërinë dhe përjashtimin shoqëror për individët e familjet (neni 2, pika a dhe b) nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre, si dhe mirëorganizimin dhe mirëfunksionimin e institucioneve shtetërore përgjegjëse për ofrimin dhe administrimin e asistencës sociale (neni 2, pika ç).

Përveç procesit të mësipërm, njësitë vendore mund të miratojnë përfshirjen në skemën e Ndhmës Ekonomike edhe për një numër të përzgjedhur aplikantësh të refuzuar, bazuar në rivlerësimin e kryer nga administratorët shoqërorë vendorë me miratimin e Këshillit Vendor¹¹.

Qeveria akordon 6 përqind të buxhetit të Ndhmës Ekonomike për pushtetin vendor në formën e grantit në bllok për të financuar pikërisht këta aplikantë shtesë për skemën e Ndhmës Ekonomike. Njësitë e pushtetit vendor, si rezultat i decentralizimit fiskal dhe administrativ të Shqipërisë që filloi të zbatohet në vitin 2015, mund të akordojnë edhe fonde shtesë nga buxheti i tyre për këtë qëllim¹². Kjo masë synon zvogëlimin e gabimeve të mundshme në aspektin e shënjestrimit që rezultojnë nga formula e pikëzimit.

Sa më sipër, bashkitë si institucionet në nivel lokal më afër qytetarëve duhet të sigurojnë mekanizmat ligjorë e financiarë për nxjerrjen e tyre nga mjerimi. Është

¹¹ Ligji Nr.57/2019 “Për Asistencën Sociale”, neni 21:

Këshilli bashkiak miraton kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, bazuar në vlerësimin social-ekonomik të kryer nga administratori shoqëror. Familjet në nevojë trajtohen nga fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, duke përfshirë ose jo edhe fonde të buxhetit vendor. Përdorimi i fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

¹² VKM nr.955, datë 7/12/2016 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të ndihmës ekonomike, Udhezimi nr.5 datë 17/02/2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6%”.

në misionin e organeve të qeverisjes vendore e kryesisht të bashkive, që të sigurojnë qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve¹³. Ato vendosen në pozicion pro-aktiv në lidhje me ofrimin e mbështetjes sociale në mënyrë që t'u krijojnë qytetarëve mundësitë për një jetë të përshtatshme e dinjitoze. Për të adresuar problematikën e evidentuar dhe për të kontribuar në përmirësimin e qasjes, institucionet e pushtetit vendor si institucionet përgjegjëse, duhet të garantojnë standardet më të larta për qeverisje në nivel sa më afër qytetarëve bazuar në parimin e subsidiaritetit. Organet e qeverisjes vendore, përkundrejt ankuesve por edhe përkundrejt adresimit të situatës në tërësiduhet të garantojnë standardin e nevojshëm për qeverisje, garanci social ekonomike për qytetarët e grupet në nevojë dhe standartin e nevojshëm të garantimit të të drejtave thelbësore të qytetarëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit monitoron me shumë vëmendje, masat e marra nga autoritetet shqiptare për kategoritë më të rrezikuara me qëllim garantimin e jetesës normale/ dinjitoze për shtresat në nevojë.

Në këtë kontekst, Avokati i Popullit vlerëson se qasja ndaj familjeve/ individëve në nevojë dhe jo vetëm, që duhet të ketë bashkia si organ kyç i pushtetit vendor, më afër qytetarit se çdo organ tjetër, për të garantuar mbrojtjen sa më efektive të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre, duhet të jetë e tillë që marrja e shërbimeve publike të mos i mohohet asnjë qytetari, pavarësisht rrethanave të veçanta. Organi i pushtetit vendor duhet të reflektojë një sjellje e cila të mos jetë përjashtuese apo diskriminuese kundrejt grupimeve të caktuara të qytetarëve të cilët kanë të drejta të barabarta, pavarësisht gjendjes apo përkatësisë ekonomike, sociale, kulturore, etnike, arsimore, etj. Bashkia duhet të mbështesë dhe të vërtetojë qasjen apo sjelljen që ka pasur dhe ka ndaj qytetarëve në këto raste të vështira humane. Mbështetja për sigurimin e të drejtave të njeriut, së bashku me mbrojtjen e anëtarëve më të prekshëm të komuniteteve tona nga një kërcënim ekzistencial, është një qëllim legjitim. Varfëria është shume komplekse si: mungesë e të ardhurave,

¹³ Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 3 përcakton: “Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

- a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;
- b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;
- c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
- ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;
- d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;
- dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithë-përfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;
- e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative”.

mungesë shërbimesh dhe pjesëmarrjeje në shoqëri, të cilat janë thelbësore për gëzimin e të drejtave të njeriut. Varfëria si shkak, por edhe si pasojë e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duhet të adresohet në kontekstin e detyrimeve të shtetit për respektimin e garantimin e të drejtave të njeriut. Një qasje e bazuar në të drejtat e njeriut, do të thotë që standardet dhe parimet e të drejtave të njeriut të jenë në thelbin e planifikimit dhe politikave shtetërore.

Në këtë kuptim, përgjigja e institucioneve vendore përgjegjëse duhet të jetë urgjente, dhe e koordinuar dhe në mbështetje të sa më shumë kategorive në nevojë. Ofrimi i ndihmës konkrete dhe i mjeteve bazë të jetesës, për të përballuar dhe kapërcyer sa më denjësisht situatat e vështira të familjeve në nevojë, kërkojnë një vlerësim objektiv dhe të menjëhershëm si dhe garantim të shërbimeve bazë sociale.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të përmbushjes së misionit ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe nenin 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”;

R E K O M A N D O N:

- *Marrjen e masave të menjëhershme për trajtimin e ankesës, vlerësimin e mundësive për ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për familjen M., sipas legjislacionit në fuqi.*
- *Evidendimin e përgjegjësiave të stafit të Bashkisë Vorë për mosbashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit, dhe marrjen e masave konkrete për të mos u përsëritur kjo situatë në të ardhmen.*

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor, parashikuar nga neni 22 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj!

KOMISIONERE

Vilma SHURDHA

DV